

SEIT MANSAKU**TRADITA E SHKRIMIT TE SHQIPES DHE ‘FORMULA E PAGËZIMIT’***

Rruga që ka përshkuar gjuha shqipe gjatë shekujve për t'i shpëtuar trysnisë asimiluese të gjuhëve të perandorive me të cilat është ndeshur për rreth gati dy mijëvjeçarë në truallin e vet dhe për t'u bërë gjuhë shkrimi, gjuhë kulture dhe gjuhë letrare e kombit shqiptar ka qenë e gjatë dhe e mundimshme. Ndriçimi i kësaj rruge me mjete dhe me metoda shkencore ka qenë dhe mbetet një nga drejtimit themelore të shkencave filologjike shqiptare. Me të janë marrë disa nga studiuesit më në zë të kësaj fushe. Me gjithë arritjet e shënuara nga kërkimet e bëra gjatë një periudhe prej gati dy shekujsh, në këtë rrugë ka ende disa fragmente të pandriçuara sa duhet, sidomos ato që i përkasin periudhës mesjetare të saj. Zhvillimet kulturore në këtë periudhë, siç dihet, kanë qenë të lidhura ngushtë e të ndërthurura me jetën dhe me veprimtaritë kishtarë të vendit. Kisha në mesjetë kishte monopolin e dijës e të kulturës. Mirëpo kjo sferë kërkimesh në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, kur studimet në fushën e shkencave filologjike i morën në dorë studiuesit shqiptarë, në kushtet kur shteti shqiptar ishte deklaruar hapur kundër besimeve fetare, nuk mund të gëzonte inkurajimin dhe mbështetjen e duhur. Kërkimet nëpër bibliotekat dhe në arkivat e Vatikanit, vendburime themelore për të gjetur tekste të vjetra dhe dokumente për gjuhën shqipe dhe për historinë mesjetare shqiptare, kanë qenë të pamundura për studiuesit tanë. Pikërisht për këto arsye të dhënat për dokumentet dhe tekstet e vjetra në gjuhën shqipe i kemi kryesisht nga studiues të huaj ose nga arbëreshët e Italisë. Kështu të tre dokumentet në shqip të shekullit XV i kanë zbuluar studiues të huaj në gjysmën e parë të shekullit të kaluar. *Formulën e pagëzimit* e zbuloi dhe e botoi për herë të parë në vitin 1915 studiuesi rumun Nikolla Jorga, *Fjalorthin e Arnold von Harffit* e botoi në vitin 1867 gjermani von Grotte, *Ungjillin e*

* Ky shkrim është mbajtur si kumtesë në konferencën shkencore kushtuar 545 vjetorit të Formulës së Pagëzimit, organizuar në Muzeun Historik Kombëtar në nëntor 2007.

Pashkës, që mendohet të jetë i fundit të shekullit XV ose i fillimit të shekullit XVI, e zbuloi studiuesi grek Llabros Spiridon në vitin 1909. Për fatin tonë të mirë, librin e parë në gjuhën shqipe, monumentin e madh të gjuhës e të kulturës sonë, *Mesharin e Gjon Buzukut* e zbuloi njeri prej shkrimtarëve të teksteve të vjetra Gjon Nikollë Kazazi prej Gjakove më 1740 dhe e rizbuloi, pas një harrese prej më se një shekulli e gjysmë, studiuesi arbëresh Pal Skiroi më 1909. Edhe një pjesë e mirë e teksteve të tjera të vjetra të shekujve XVII- XVIII janë zbuluar nga studiues të huaj e arbëreshë nga të cilët një vend nderi i takon pa dyshim filologut francez Mario Roques.

Kërkimet sistematike e afatgjata nëpër arkiva e biblioteka të qendrave të kulturës e të qendrave evropiane kanë rëndësi të jashtëzakonshme për studimet e mirëfillta filologjike. Në kohën tonë kur Shqipëria është një vend i hapur dhe kur barrierat ideologjike janë shembur e po bëhen hapa për t'u integruar në të gjitha fushat në botën euroatlantike, është e domosdoshme që edhe shkencave albanologjike t'u krijohen mundësi dhe hapësira të reja kërkimore për të pasuruar njohjen e historisë, të gjuhës dhe të kulturës sonë kombëtare me fakte e dëshmi të reja e me argumente të reja për mjaft teza e hipoteza të hedhura në qarkullim, por që qëndrojnë ende pezull midis të vërtetave dhe hamendjeve për mungesë provash të mjaftueshme. Është një gjë e njohur, por jo e panevojshme të ritheksohet se përparimet në çdo fushë të shkencës janë të lidhura ngushtë me zbulimin dhe interpretimin e fakteve të reja dhe me zbatimin e metodave të reja të kërkimit. Në fushën e filologjisë shqiptare dhe në mënyrë më të përcaktuar në fushën e dokumentimit të gjuhës shqipe, nga datat që shënojnë momente të rëndësishme për identifikimin dhe pastaj shkrimin e shqipes në periudhën e vonë mesjetare, do të duhej të përmendnim fundin e shekullit XIII, më saktë vitin 1285 kur gjuha shqipe përmendet për herë të parë si krejt rastësisht në një dokument gjyqësor në latinisht të gjetur në arkivat Dubrovnikut në të cilin është shkruar kjo frazë: “*Audivi in monte unam vocem clamantem in lingua albanesca*”, që në shqip do të thotë: “dëgjova në mal një zë që thërriste në gjuhën shqipe”. Ky nuk është një dokument i shkruar në shqip, pra nuk është një dokument që dëshmon se shqipja ka qenë shkruar në këtë kohë, por gjithsesi ka një vlerë historike, sepse në të përmendet, me njohjen që kemi deri sot, për herë të parë gjuha shqipe.

Në gjysmën e parë të shekullit XIV nëpër relacione të ndryshme të udhëtarëve ose të klerikëve që njohën sadopak vendin e arbërve, krahas

të dhënave me interes për historinë dhe gjeografinë e vendit, ka edhe shënime në latinisht për gjuhën shqipe si një gjuhë krejt e ndryshme nga latinishtja. Meritojnë të përmenden shënimet e udhëtarit anglez Symeon Symeonis të vitit 1322 dhe sidomos dhjetë vjet më vonë relacioni i njohur i Kryepeshkopit të Tivarit Guljelmi i Adës, i cili pohon në latinisht se "megjithëqë shqiptarët kanë një gjuhë krejt të ndryshme nga latinishtja, ata kanë në përdorim dhe në të gjithë librat e tyre shkronjën latine (*litteram latinam*).” Shprehja e fundit *litteram latinam*, siç dihet, është interpretuar në dy mënyra, si alfabet latin, ose si gjuhë latine, prandaj nuk është e sigurt nëse në këtë fragment bëhet fjalë për libra në gjuhën shqipe të shkruar me alfabet latin apo për libra në gjuhën latine. Sido që të jetë, besoj se është e rëndësishme të vihet në dukje se në këto dokumente del se shqipja, të paktën që nga fillimi shekullit XIV nis të përmendet si element identifikimi etnik për popullsinë vendase, si tipar i rëndësishëm që i dallon shqiptarët nga elementët e tjerë etnikë të qyteteve, sidomos nga elementi roman. Dokumentet e kohës dallojnë herë pas here elementët etnikë latinë dhe arbën (*Latini et Albani*) në qytetet bregdetare shqiptare, dallim që bëhej para së gjithash mbi bazën e gjuhës që flisnin, sepse, për sa i përket fesë, të dyja palët përmenden si të besimit katolik roman. Ndërsa, për nga origjina, elementi roman përbëhej nga popullsi vendase e romanizuar dhe nga kolonë, tregtarë, klerikë e funksionarë të administratës të ardhur nga përtejdeti.

Para shekullit XV, siç pohon tani së fundi historiani gjerman Oliver Schmitt¹, si pikë referimi për identitetin nuk ishte përkatësia në një bashkësi gjuhësore, por e drejta qytetare, pozita juridike, shoqërore, ekonomike dhe individuale. Edhe një historian i njohur i mesjetës si Milan von Šufflay ka shkruar se njëësia e komunës nuk karakterizohej nga gjuha. Vetëdija e statusit të veçantë juridik kundrejt banorëve të veçantë të një krahine nuk ishte vetëm një madhësi abstrakte, por konkretizohej në imazhe e në simbole. Shprehja e dikurshme e bashkësisë ishte asambleja e popullit dhe e ipeshkvit prej së cilës buronte sovraniteti i komunës.²

Pas përmendjeve të para të gjuhës shqipe si gjuhë e dallueshme nga latinishtja, Guljelmi i Adës në relacionin e tij shkon edhe më tej kur shkruan se shqiptarët kanë librat e tyre të shkruara me alfabet latin ose në gjuhën latine, sipas interpretimit të dyfishtë që lejon shprehja latine

¹ Oliver Schmitt, *Arbëria Venetike*, Tiranë 2007, f.129.

² Milan von Šufflay, *Acta et Diplomata*, 27.

litteram latinam. Sidoqë të jetë, fakti që shqiptarët, ose më saktë arbit, kishin librat e tyre të paktën që në fillim të shekullit XIV, siç pohon dokumenti i sapopërmendur, qofshin këta në gjuhën shqipe ose në gjuhën latine, nuk është pa rëndësi për historinë kulturore të popullit shqiptar.

Të gjitha këto shënime që përmendëm ishin në gjuhën latine. Duhej të prisnim shekullin XV që të kemi tashmë lumturisht shkrimet e para në gjuhën shqipe: *Formula e pagëzimit* (1462), *Fjalorthi i Arnold von Harffit* (1497) dhe *Ungjilli i pashkëve ose Perikopeja e ungjillit*, pa datë të shënuar, por që mendohet të jetë i fundit të shekullit XV ose i fillimit të shekullit XVI.

Nuk është një rastësi që fillimet e shkrimit në gjuhën shqipe datojnë në shekullin XV, në mesin e këtij shekulli, sipas dëshmimeve që njohim deri më sot. Në rrafshin politik, në mesin e shekullit XV shqiptarët, pas disa betejave ngadhënjimtare nën udhëheqjen e prijësit të tyre Gjergj Kastriotit - Skënderbeut kundër Perandorisë osmane, po rrezikonin të binin nën sundimin e egër osman. Procesi i islamizimit të vendit kishte filluar e po përparonte pa u ndalur. Nga ana tjetër, në rrafshin fetar, pas rënies së Perandorisë bizantine dhe asaj sllave, krishterimi katolik, siç kanë vënë në dukje historianët, kishte njohur përhapjen më të madhe në Arbëri, duke u shtrirë jo vetëm në të gjithë Veriun e vendit por edhe në krahinat qendrore; numri i besimtarëve ortodoksë të rritit grek po rrudhej. Në fillim të viteve '60 të shekullit XV, pas një marrëveshjeje armëpushimi që kishte bërë Skënderbeu me Sulltan Mehmetin e dytë, vendi po kalonte njëfarë qetësie relative, megjithatë rreziku i shtrirjes së sundimit osman në të gjithë vendin dhe i përhapjes së shpejtë të islamizimit ishte kërcënues. Në këto rrethana historike e kulturore, gjuhësore e fetare me nismën e Pal Engjëllit, arqipeshkv i Durrësit dhe njeri nga bashkëpunëtorët më të ngushtë të Skënderbeut më 8 nëntor të vitit 1462 në manastirin e Shën Trinisë të rrethit të Matit u mblodh Kuvendi kishtar i Matit, i cili i dha gjuhës dhe kulturës shqiptare dokumentin e parë që njohim deri më sot të shkruar në gjuhën shqipe, Formulën e pagëzimit: *Unte paghesont premenit Atit, et birit et spertit senit*.

Formula e pagëzimit, kjo frazë e shkurtër e shkruar shqip, ka një domethënie të madhe historike e kulturore, gjuhësore e fetare. Ajo mund të vlerësohet si shkëndijë e parë e një lëvizjeje më të gjerë mendore e kombëtare për ta shndërruar gjuhën shqipe, deri atëherë vetëm gjuhë e folur popullore, në një gjuhë të shkruar dhe për ta futur përdorimin e saj në shërbesat fetare e për ta ngritur në gjuhë kulture.

Vendimi për të thënë në gjuhën shqipe këtë formulë të besimit të krishterë në shek.XV ishte një akt i guximshëm emancipues e atdhetar, po të kemi parasysh që autoriteti i latinishtes si gjuhë universale e kishës katolike në këtë kohë ishte ende i padiskutueshëm në vendet që nuk kishin krijuar liturgjinë e tyre. Më shumë se një shekull e gjysmë më vonë Pjetër Budi në veprën e tij "Rituali roman" (1618) do të këshillonte trajtën latine, duke shkruar se kjo formulë *kështu duhet me u thanë gjithherë e jo ndryshe e mbë tjetër arsye* (f.37) dhe më tej shton *mirë tue ditunë se në gjuhun tanë këto kafshë pak e rrallë goditenë e se ndo goditen s kuxonjënë ndë këtë kohë koram (para) popullë atë kafshë me e përmendunë*³. Megjithatë edhe ky autor po në këtë vepër në një vend tjetër do të shkruajë se në raste të jashtëzakonshme, kur foshnja kishte rrezik të vdiste pa u pagëzuar, *aty gjithkush ka të lirë e mundësi me e pagëzuom, sido e mbëqyshdo gjuhu të jetë o prift, o gjakon, o shekullar*. Nga sa duket edhe Budi duhet t'i ketë njohur aktet e Kuvendit të Matit.

Në krahasim me dokumentet e tjera shqip të shek.XV, besoj se Formula e pagëzimit është dokumenti më i rëndësishëm për këto arsye:

Së pari, sepse kronologjikisht është dëshmia e parë shqip e datuar në mënyrë të përpiktë, e lëshuar në një kuvend kishtar të rëndësishëm që me të drejtë është quajtur reformator si për vendimet që mori për përmirësimin e shërbimeve kishtarë në këtë krahinë, ashtu edhe për lejimin e përdorimit të kësaj formule në gjuhën shqipe nga vetë prindërit për pagëzimin e fëmijëve në rastet kur nuk kishte prift ose nuk kishte kishë aty pranë.

Së dyti, ky dokument është i rëndësishëm, sepse është shkruar me nismën dhe nën kujdesin e një njohësi të mirë të gjuhës shqipe dhe të një personaliteti të shquar të kohës siç ishte Pal Engjëlli për të cilin Marin Barleci thotë se ishte burrë i pajisur me mendje të lartë, me zotësi të rrallë në të folur, me dituri si askush dhe i kultivuar në letërsinë e shenjtë dhe humane si greke dhe latine. Kjo e bën plotësisht të besueshëm atë nga ana gjuhësore si një dokument autentik. Fjalorthi i Arnold von Harfit, i shkruar 35 vjet pas tij më 1497 nga një udhëtar i huaj gjerman që nuk e njihnte shqipen, por i ka riprodhuar fjalët dhe shprehjet e shqipes ashtu siç ka mundur t'i dëgjojë, edhe pse ka më shumë lëndë gjuhësore, nuk ka atë vlerë autentike si Formula e pagëzimit. Grafia e tij nuk ka shumë siguri për t'u shfrytëzuar për interpretime studimore fonetike.

³ Shih E.Çabej, *Studime gjuhësore* VI, Prishtinë, 1977, f. 345.

Po kështu edhe dokumenti i tretë shqip, Ungjilli i Pashkës, me rëndësi të veçantë nga pikëpamja historike e kulturore, sepse është dokumenti i parë i shkruar në dialektin e Jugut dhe me alfabet grek, nga ana e mirëfilltë gjuhësore nuk paraqet ndonjë interes të veçantë, sepse duket të jetë përkthyer a kopjuar nga një shkruer që nuk duhet ta ketë njohur mirë gjuhën shqipe, prandaj teksti ka trajta drejtshkrimore e morfologjike të pasakta dhe shumë fjalë greke.

Formula e pagëzimit, e shpallur dhe e sanksionuar me shkrim në shqip në Kuvendin e Matit më 1462, e vështruar nga ana gjuhësore, duket se nuk është një përkthim i atypëratyshëm i formulës përgjegjëse latine. Teksti shqip i Formulës, siç ka vërejtur E. Çabej, duhet të ketë qenë përdorur edhe më parë në gjuhën e folur, si nga kleri katolik ashtu edhe nga besimtarët e thjeshtë. Kështu që shkruerit të akteve të Kuvendit i është dashur të riprodhojë me shkrim këtë frazë të thjeshtë të njohur e të përdorur në gjuhën popullore të krahinës. Këtë e tregojnë trajtat fonetike dialektore që i përkasin së folmes së Matit siç është trajta fonetike *spertit* në vend të *shpirtit*. Përveç veçorive fonetike, është me interes të vihet në dukje edhe një dallim sintaksor i pa vënë re deri më sot, midis tekstit latin dhe tekstit shqip të Formulës. Në latinisht kemi: *Ego te baptizo in nomine Patri et filii et spiriti sancti*. Ky tekst latin në shqip do të përkthehej fjalë për fjalë kështu: “Unë të pagëztoj në emër të Atit, të birit e të shpirtit të shenjtë”. Por sintagma parafjalore latine *in nomine* “në emër” është përkthyer me sintagmën shqipe *për emën*, ashtu siç thuhej në gjuhën popullore. Në këtë trajtë sintaksore është përdorur kjo formulë edhe rreth një shekull më vonë të “Meshari” i Gjon Buzukut: *Gjon, u ty të pagëzoni pr emënë të Atit e Birit e shpirtit shenjt* (f. 79/ 2). Pra duket se formula e pagëzimit ishte përgjithësuar në trajtën shqipe të sipërpërmendur në komunitetin katolik shqiptar të shekullit XV. Sintagma parafjalore *për emër* në vend të *në emër*, ndjekur nga një emër i rasës gjinore, përdoret edhe sot në formula të betimit si: *për emër të Zotit, për emër të Allahut, etj*. Ndërsa në stilin administrativ sot është përgjithësuar shprehja *në emër të*, e cila ka hyrë më vonë në gjuhën shqipe nga gjuhët moderne. U ndalëm në komentimin e kësaj shprehjeje, sepse nuk është pa rëndësi për historinë e përkthimeve të teksteve fetare pavarësia sado e vogël e tekstit shqip nga teksti latin, sidomos kur është fjala për formula të rëndësishme të besimit të krishterë e pothuajse të ngurosura, siç është formula e pagëzimit. Terminologjia fetare dhe stili kishtar kanë filluar të përpunohen e të nguliten në komunitetin e krishterë shqiptar edhe para se të shkruhej gjuha shqipe, kur ajo përdorej në shërbesa, në ceremoni e rite

fetare si gjuhë e folur. Edhe në Mesharin e Gjon Buzukut ka shumë pjesë tekstesh fetare që tingëllojnë si origjinale me fjalë e ndërtime sintaksore karakteristike për shqipen, për shkak të përdorimit të gjatë e përpunimit të tyre gjuhësor në gojë të komunitetit shqipfolës.

Për sa i përket grafisë, më e rëndësishmja që meriton të theksohet është fakti se Formula e Pagëzimit, dokumenti i parë i shqipes së shkruar, është me alfabet latin, çka flet për një orientim kulturor e fetar të shqiptarëve drejt perëndimit latino-roman. Alfabeti i Formulës ka disa shkronja me vlerë të ndryshme nga ato që kanë në italishte. P. sh., për të shënuar tingullin *sh* në tekstin e Formulës është përdorur shkronja e thjeshtë *s*: *spertit*, *senit*, ndërsa për të shënuar tingullin *nj* është përdorur grafia *ni*, kur dihet se italishtja përdor *sc* për *sh* dhe *gn* për *nj*. Duke u nisur nga këto dallime në grafi dhe duke pasur parasysh se autorët e vjetër në tekstet e tyre që vijnë pas Formulës në shekujt XV-XVI Buzuku, Matrënga, Budi, Bardhi e Bogdani kanë përdorur për këta tinguj grafitë përkatëse të italishtes, me të drejtë është menduar se këto grafi të Formulës së Pagëzimit mund të paraqesin një gjendje më të vjetër të traditës së shkrimit të shqipes.

Duhet theksuar se konteksti latin ku është vendosur teksti shqip i Formulës, pas sintagmës *in vulgari Albanico*, na jep ndoshta një dëshmi të tërthortë për ekzistencën e shkrimeve shqipe para shekullit XV. Në veprën latinisht të Marin Barletit *De obsidione scodrensi* bëhet fjalë për anale ose më saktë për fragmente të shkruara *in vernacula lingua* "në gjuhën e vendit". Ndoshta shprehja e Barletit *in vernacula lingua* është e baraykuptimshme me shprehjen *in vulgari Albanico*.

Me rastin e përkujtimit të 500-vjetorit të dokumentit të parë të shkruar në gjuhën shqipe, 50 vjet më parë, njohësi dhe studiuesi i shquar i historisë dhe i kulturës mesjetare shqiptare z. Injac Zamputi pati propozuar që, pasi të përcaktohet më me siguri vendi ku u mbajt Kuvendi i Matit dhe ku u shpall për herë të parë publikisht në shqip Formula e Pagëzimit, të ngrihej një monument përkujtimor. Nëpërmjet mjeteve të informimit publik, u njoftuam se ky monument sapo është përruar. Ky është një lajm i mirë, sepse i jepet vendi i duhur një momenti të rëndësishëm të historisë së kulturës sonë kombëtare.

BIBLIOGRAFI E PËRZGJEDHUR

- Çabej, Eqrem: *Studime gjuhësore VI*, Prishtinë, 1977.
Schmitt, Oliver: *Arbëria Venetike*, Tiranë 2007.

Šufflay, Milan von: Acta et Diplomata.

SUMMARY

*THE WRITING TRADITION OF ALBANIAN LANGUAGE AND “THE
FORMULA OF BAPTISM”*

The beginnings of writing of the Albanian Language dates back to the 15th century. Prior this century, there are only some data which make us think that Albanian might have been written even before. Anyhow, the “Formula of Baptism” of the year 1462 remains the first document written in the Albanian language known until now. It can be regarded as the first spark of an intellectual movement of Albanians to transform the Albanian language, until then only a spoken popular language, into a written language and to introduce it in the religion ceremonies.

By comparison with other Albanian documents of the 15th century, the “Formula of Baptism” is the most important one because it is the first one and because it is written on the initiative and under the care of an outstanding personality of the time, Pal Engjëlli, archibishop of Durrës.

The “Formula of Baptism”, put down in Albanian writing on November 8, 1462 at the ecclesiastical Convention of Mat, must have been used before in the spoken language of the people of the region of the country. It is written in the Mat idiom, in Latin alphabet. It has been discovered and published for the first time in 1915 by Rumanian scholar, Nokolla Jorga.